

E nderuar Znj. Ministre Kodheli, I nderuar Z. Ministër Klosi

Të dashur miq dhe kolegë

Është një privilegj për mua të trajtoj me ju në këtë Takim prezantues që synon të ngrejë zërin për një debat të vazhdueshme në Shqipëri për Gratë, Paqen dhe Sigurinë.

Në fillim më lejoni të shpreh vlerësimet e mia për Shoqatën e Grave me Probleme Sociale dhe partnerit të saj Operation 1325 për risinë e fokusit e tyre për Rezolutën 1325 të KB. Ndihem mirë që jam këtu për të diskutuar së bashku mënyrën se si kjo rezolutë e rëndësishme mund të përkthehet në kontekstin shqiptar.

Në vitin 1945, Statuti i Kombeve të Bashkuara u nënshkrua nga përfaqësuesit e 51 vendeve. Sot 71 vjet më vonë, ka trefish më shumë popullsi në botë dhe katër herë më shumë anëtarë të KB. Gjatë këtyre 71 viteve, bota ka parë shumë rrëmujë dhe ndërrime të pushtetit. Ne kemi parë zhvillim, por gjithashtu dhe konflikt interesash, konflikte të hidhura dhe tragjedi njerëzore. Ndërkohë që ne flasim, jeta e miliona njerëzve dominohet nga frika dhe shtypja. Ende, KB legjitimojnë platformën për dialog ndërkombëtar, ku shtetet mund të vijnë gjithmonë së bashku, duke mos patur rëndësi ndryshimet e mëdha mes tyre. Për Hollandën, Kombet e Bashkuara është organizata e parë botërore për paqen, drejtësinë dhe zhvillimin.

Barazia gjinore është një nga mundësitë kryesore të shekullit 21; gjithashtu një sfidë, por më shumë një mundësi. Po të shohim panelin tonë, Zonjat përbëjnë shumicën. Me vjen keq Zotërinj, por ka ardhur koha. Talentet e grave duhet të përdoren që në fillim, jo si një mendim i mëvonshëm.

Kjo rezoluë e KB 1325 është nxitur për 20 vjet nga grupet e grave nga jugu. Këto grupe kanë synuar një ndryshim paradigme dhe një lloj tjetër sigurise; sigurinë njerëzore. Holanda ishte pikërisht aty dhe nxiti adoptimin e Rezolutës 1325 para 20 vitesh, ndërkohë që ishim të ulur në Këshillim e Sigurisë të KB. Hollandezët shpresojnë të kenë vend në Këshill sërish në 2017/2018. Ne duam të jemi atje për të qenë në gjendje të mbajmë dhe të forcojmë Gratë, Paqen dhe Sigurinë në axhendën e Këshillit. 1325 duhet të bëhet realitet i jetuar.

Pse ne mendojmë se është kaq e rëndësishme?

Për shkak të rolit që mund të luajnë gratë në konflikt dhe në paqe. Dhuna me bazë gjinore është ende e pranishme, gratë janë lider për paqen, por gjithashtu mund të jenë aktore në për shkallëzimin e konfliktit. Shikoni çfarë po ndodh sot, në gjithë konfliktet dhe refugjatët, gratë dhe vajzat janë më shumë vulnerabël në këto rrethana të vështira. Ne duhet ti fuqizojmë ato.

Ne duhet të besojmë në fuqinë e gruas. Ato duhet të jenë pjesëmarrëset kyç në vendim marrjet politike, në parandalimin e konfliktit, në zgjidhjen e konfliktit, në shërimin e konfliktit. Holanda po punon shumë për të realizuar këtë. Po ju jap disa shembuj. Ne po përpiqemi të ndihmojmë të sjellim gratë Siriane në tryezën e negociimit për paqen. Së bashku me Spanjën ne organizuam një

trainim një vjeçar për çështjet gjinore në operacionet paqeruajtëse. Për me tëpër ka dhe shumë burra që luftojnë për të drejta të barabarta. Pa mbështetjen aktive të bashkëshortit tim unë nuk do të isha në gjendje të isha këtu ku jam sot. Ne kemi rritur dy djemtë dhe vajzën tonë duke i treguar se kanë të njëjtat mundësi dhe përgjegjësi. Jam krenare që jam ambasadore dhe mbështes UN Women, për të përfshirë sa më shumë burra dhe gra shqiptare në këtë fushatë.

Ne duhet të përfshijmë axhendën për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, gjatë hartimit të përgjigjeve për këtë situatë të tmerrshme. Është e shkëlqyer që trainerët shqiptarë të ushtrisë dhe policisë janë të përfshirë në operacionet paqeruajtëse. Shpresoj që disa nga ato janë femra. Ne duhet të mbështesim gjithashtu rolin e grave si nëna, bashkëshorte dhe motra, në luftë kundër ekstremizmit të dhunshëm. Ne, gjithashtu, duhet të forcojmë shoqërinë civile të grave, gjithashtu pjesëmarrjen politike të grave dhe lidhshpimin.

Shumë shtete mbështesin axhendën e Rezolutës 1325 dhe Shqipëria është një ndër to. Është e rëndësishme të kemi mbështetje të gjatë institucionale dhe të programuar, gjithashtu dhe fonde për të gjithë bashkëpunëtorët, OSHC – e të përfshira që punojnë në nivel kombëtar. Unë besoj që ky është momenti që Shqipëria të zhvillojë një Plan Kombëtar Veprimi 1325 si një mjet për politikën bashkëkohore, një proces që i ka të gjitha mundësitë për një ndryshim real dhe kuptimplotë. Do të ndërgjegjësojë dhe shikojë gratë si agjente politike për ndryshim.

Zhvillimi i një Plani Kombëtar për paqen është një pikë hyrëse për të drejtat e grave dhe fuqizimin e tyre, e në të njëjtën kohë njohje të angazhimit të Shqipërisë për Gratë, Paqen dhe Sigurinë. Në Hollandë, Plani ynë i Veprimit është një bashkëpunim ndërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, Drejtësisë, Zhvillim Bashkëpunimit dhe më shumë se 50 shoqatave. Është një model që ka funksionuar.

Premtimet e Rezolutës 1325 nuk mund të realizohen pa mbështetjen e plotë të aktivistëve të shoqërisë civile, pa punën individuale të grave ndërtuese të paqes dhe organizatave si model i rrisë, kurajos, dhe praktikës së mirë. Dhe sot unë shoh një dhomë plot me kapacitete të tilla, dhomë plot me dëshirë dhe angazhim politik, plot me mbështetje dhe ekspertizë ndërkombëtare. Kështu ju ftoj të gjithëve të bashkojmë duart dhe ta bëjmë realitet!

Në përfundim

Së bashku ne duhet ta mbajmë axhendën për Gratë, Paqen dhe Sigurinë si një prioritet. Së bashku ne duhet të përkthejmë fjalët tona në veprime konkrete.

Duke fuqizuar gratë

Duke promovuar barazi gjinore

Duke investuar në trajnime

Duke punuar së bashku me shoqërinë civile

Duke mësuar nga njëri – tjetri

Duke e parë gruan si lider dhe jo vetëm si viktimë.

Hollanda ka ambicien për të qenë një partner afatgjatë për paqen, drejtësinë dhe zhvillimin. Gratë janë thelbësore në të tre këto sfera.

Faleminderit për vëmendjen tuaj.